

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

(Të gjitha balancat janë në lekë)

1. Informacione të përgjithshme

“ALMO Konstruksion” Sh.p.k, është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me 28 Mars 1996. Kapitali rregjistruar është 170.000.000 leke dhe zotërohet nga 2 ortakë, të cilet janë: 1.Edmond Bitri 50% dhe 2.Alfons Bitri 50%

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqërisë për vitin ushtrimor 2024 janë shërbimet në fushën e ndërtimit të punëve publike.

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar ‘Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare’ dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elementetë metodave të tjera dhe parimit të drejtave të konstatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar (“lekë”).

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2024 është zbatuar formati i SKK-2.

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e shërbimeve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tregtarëve dhe në të njëjtin ushtrim kontabel me të ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetare të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetare, të shprehur në monedhë të huaj, maten në terma të kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2024 janë sipas kursit të rakorduar me bankat.

➤ Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për të paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Shoqëria për vitin për 2024 rezulton me fitim në shumën **2,264,047** lekë.



Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në para regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Gjendjet e inventareve

Vleresimi në hyrje i inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventaret në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është çmuar si vlera neto të realizueshme.

3. Aktive afatshkurtra

Në fund të ushtrimit kontabel 2024 deklarohen si vijon: Kërkesat e arketueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të periudhës raportuese

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja në 31.12.2024		Gjendja në 31.12.2023	
		Në leke	Në valute	Në leke	Në valute
Banka	Leke	6,787,264		1,038,704	
Arka	Leke	589,192		27,125	
Te tjera marrdhenie me pronaret	Leke	58,180,000		58,180,000	
Borxhe të dhena	Leke	5,158,700			
Nga aktiviteti i shfrytëzimit	Leke	111,737,156		137,370,041	
Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	Leke	9,797,784		6,731,518	
Tatim fitimi i mbipaguar	Leke	3,005,648		532,564	
Parapagime për blerje mallrash	Leke	6,486,667			
Shuma		201,742,411		203,879,952	

- Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave.

- Në llogarinë "Te tjera marrdhenie me pronaret", është paraqitur një sasi e vlerave monetare të shoqërisë që janë tërhequr nga pronaret e shoqërisë.

- Në llogarinë "Borxhe të dhena", është paraqitur një borxh i dhënë nga shoqëria "ALMO Konstruksion" Sh.p.k. për shoqërinë "ULZA" Sh.p.k..

- Në llogarinë "Nga aktiviteti i shfrytëzimit" janë pasqyruar faturat e papaguara për shërbimet e ndërtimit që shoqëria ka realizuar gjatë ushtrimit. Kjo llogari është e rakorduar me llogaritë analitike për çdo klient.




- Ne llogarine “Lende e pare dhe materiale te konsumueshme” eshte pasqyruar vlera e inventarit ne fund periudhes.Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te perhershem.
- Ne llogarine “Tatim fitimi i mbipaguar” eshte pasqyruar vlera e tatim fitimit te mbipaguar per vitin 2024.
- Ne llogarine “Parapagime per blerje mallrash” eshte pasqyruar vlera e parapagimeve per blerje mallrash.

4. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet:

Nr.	EMERTIMI	01.01.2024	SHTESA (Blerje)	PAKSIME (shitje)	AMORTIZIM	31.12.2024
1	Toka dhe ndertesa	20,000,000	13,000,000	-		33,000,000
2	Makineri paisje	30,365,538	5,432,473	677,405	6,008,490	29,112,116
3	Mjete transporti	15,217,150	300,000	152,001	2,757,075	12,608,074
4	Kompjuterike	965,656	67,750	-	256,940	776,466
5	Zyre	709,805	-	-	141,961	567,844
6	Aktive te qend. patrupezuara	725,290	-	-	108,794	616,497
	Totali:	67,983,439	18,800,223	829,406	9,273,260	76,680,996

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor.Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, eshte zgjedhur metoda lineare.

Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane njejta me ato qe perdoren per qellime fiskale. Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

Aktive jo materiale:

Shoqeria ka nje emer te mire me vlere prej 616.497 leke

5. Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet - Huatë dhe Parapagimet

Huate dhe parapagimet afatshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel paraqiten si vijon:

	Ushtrimi mbyllur 2024	Ushtrimi mbyllur 2023
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	70,625,000	64,829,172
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	18,848,264	28,813,586
Te ardhura te shtyra	12,400,857	
Të pag. ndaj punonjësve dhe sig.shoq./shënd.	1,008,519	682,799
Të pagueshme për detyrimet tatimore	4,544,890	933,025
Shuma	107,427,531	95,258,581



- Ne llogarine "Detyrime ndaj institucioneve te kredise" jane paraqitur overdraftet qe ka shoqeria me institucionet bankare.
- Ne llogarine "Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.
- Ne llogarine "Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit" pasqyron vleren e fatura qe jane prere si paradhenie por nuk jane likujduar ndaj institucione shteterore
- Ne llogarine "Te pagueshme ndaj punonjesve, sigurimeve shoqerore dhe detyrimeve tatimore" jane paraqitur detyrimet ndaj punonjesve te shoqerise si dhe detyrimet qe jane ndaj administrates tatimore.

6. Kapitalet e veta

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqërise dhe vendimet e depozituara ne QKB. Me 31.12.2024 ai eshte 170.000.000 leke, i ndare ne 170.000 kuota ose aksione.

7. Fitimi (humbja) e vitit financiar

➤ Te ardhurat

Të ardhurat jane realizuar nga shitja e sherbimeve në vlerën 110,862,252 lekë, jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme. Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre. **Shuma pa tvsh e faturimeve per vitin 2024 eshte 123,263,109 leke. Kesaj shume i zbritet shuma e parapagimeve ne vlere 12,400,857 leke. Ka ndryshim midis FDP-ve dhe te ardhurave ne Pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.**

➤ Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumet e paguara ose te pagueshme. Kostoja e punësimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit jane treguar ne pasqyren perkatese.

8. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel dhe vitin paraardhes jane si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 2024	Ushtrimi i mbyllur 2023
Fitimi/Humbja para tatimit	-5,269,325	21,086,170
Shpenzime te panjohura	7,533,372	5,302,667
Fitimi Fiskal	2,264,047	26,388,837
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	339,607	3,958,326
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	-5,608,932	17,127,845

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatueshem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme.



9. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre, veç huase se marre nga ortakët gjatë viteve të kaluara nuk ka transaksione të tjera me palet e lidhura.

10. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimësia e shfrytëzimit

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit të pasqyrave financiare.

**HARTUESI
HAJRI ABEDINI**



**ADMINISTRATORI
ALFONS BITRI**

